

Nënshkruhet marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Institucioneve Supreme të Auditimit të Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut mbi auditimin paralel të performancës

Në datën 3 mars 2023, u nënshkrua në Shkup, marrëveshja e bashkëpunimit tripalëshe ndërmjet Institucioneve Supreme të Auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit të Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut. Kjo marrëveshje i hap rrugën auditimit paralel të performancës me titull “Barazia gjinore dhe fuqizimi i gruas nga zonat rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës”.



Ky auditim është pjesë e iniciativës së organizatës UN Women për bashkëpunimin ndërmjet SAI-ve të rajonit me në fokus Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Axhendës 2030 të Kombeve të Bashkuara.

Kontrolli i Lartë i Shtetit në këtë takim u përfaqësua nga Sekretari i Përgjithshëm, znj. Valbona Gaxha, Drejtori i Departamentit të Auditimit të Performancës, z. Alfred Zylfi, Përgjegjësi i sektorit të marrëdhënieve me jashtë dhe bashkëpunimit, znj. Dëshira Huqi, si dhe nga auditueset znj. Ermira Vojka dhe znj. Jorida Zhegu.



Në fjalën e saj, znj. Gaxha përcolli angazhimin e KLSH-së në kryerjen e këtij auditimi të rëndësishëm në nivel tashmë rajonal, duke theksuar faktin se ekipet përkatëse duhet të mbajnë në vëmendje metodologjinë e duhur, zbatimi i së cilës duhet të përkthehet më tej në

rezultate dhe indikatorë të prekshëm. Gjithashtu znj. Gaxha e vuri theksin tek koordinimi ndërmjet ekipeve të auditimit, shkëmbimi i informacioneve dhe përpunimi i të dhënave, ndër faktorët që do të përbëjnë edhe suksesin e këtij projekti.

Bashkëpunimi i ndërsjellë dhe rezultatet e këtij auditimi, do të kontribuojnë në përmirësimin e situatës të këtyre grave në tregun e punës dhe në rritjen e ndërgjegjësimit mbi çështjet e barazisë gjinore.